

MËSIMI KATËR

Udhëheqësit në kishën lokale

Përderisa kisha nuk do të përparojë përtej udhëheqjes së saj, caktimi i udhëheqësve është një punë shumë jetike, e cila kërkon një kuptim të qartë të doktrinës së krishterë. Si barinj të tufës, pleqtë punojnë bashkë, për t'u siguruar që Fjala e Perëndisë po jepet mësim, që Biri i Perëndisë po nderohet dhe që populli i Perëndisë po ndërtohet. Alistair Begg-u shpjegon që pleqësia biblike është pastorale, e përbashkët, frymërore dhe llogaridhënëse. Duke qenë të larmishëm në dhunti dhe funksion, pleqtë i japin llogari Perëndisë teksa ndajnë privilegjet dhe përgjegjësitë e udhëheqjes.

Shënime

Hyrje

Udhëheqje pastorale

Udhëheqje llogaridhënëse

Udhëheqje e përbashkët

Udhëheqje frymërore

SHKRIME KYÇ

“U bëj thirrje pleqve midis jush, unë bashkëplak dhe dëshmitar i vuajtjeve të Krishtit edhe pjesëmarrës i lavdisë që ka për t’u zbuluar: ruani tufën e Perëndisë midis jush.” (1 e Pjetrit 5:1-2)

“Kujtoni udhëheqësit tuaj, që ju thanë fjalën e Perëndisë dhe, duke vështruar rezultatin e sjelljes së tyre, imitoni besimin e tyre.” (Hebrenjve 13:7)

Vështrim në thellësi

1. *“Emërimet në Gjykatën e Lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk krahasohen me zgjedhjen e udhëheqjes së kishës lokale.”*

A mendoni se shumica e anëtarëve të kishës suaj do të binin dakord me këtë deklaratë? Në kohën tonë, shumë njerëz e përbuzin autoritetin dhe tregohen skeptikë ndaj atyre që janë në pozita udhëheqjeje. Kjo është e vërtetë, sidomos brenda kishës. Si mund të nxitni një vlerësim të lartë për udhëheqjen e kishës lokale në kontekstin e shërbesës suaj?

2. *“Plaku i kishës, i cili e merr seriozisht këtë thirrje, jeton nën trysninë e vazhdueshme të të diturit që Kryebariu do të shfaqet; dhe që do të ketë një ‘kurore lavdie që nuk fishket’.”*

Jezusi është Kryebariu, i cili një ditë do të kthehet dhe do t’u kërkojë llogari të gjithë pastorëve për besnikërinë e tyre në përkujdesjen e treguar ndaj deleve të Tij. Pse duhet që kjo të të motivojë të jesh i zellshëm dhe besnik në shërbesën tënde? Nën dritën e kthimit të Krishtit, cilat zona specifike të shërbesës suaj mund të forcohen më tepër?

3. “Atëherë, çfarë do ta mbrojë personin që e mban Biblën në duar dhe e shpall atë me buzët e tij, që të mos bëhet një kopuk arrogant, tiran, zotërues dhe autokrat? Masat korrigjuese janë të pëfshira në vetë udhëheqjen, prandaj është përgjegjësia dhe privilegji i pleqve që së bashku të sigurohen që asnjëri nga ne të mos përfundojë në atë pozitë.”

Llogaridhënia është jashtëzakonisht e rëndësishme në udhëheqjen e kishës lokale dhe në sfondin e shërbesës. Cilat janë disa prej gabimeve të zakonshme që bëjnë kishat dhe shërbesat, të cilat çojnë në mungesën e llogaridhënies? Çfarë duhet bërë për t’u siguruar që këto rreziqe të shmangen?

Mënyra për t’u lutur

- Lutu që udhëheqësit në kishën tënde lokale të shërbejnë vazhdimisht me vetëdijen se Krishti do të kthehet dhe do t’u kërkojë llogari për shërbesën e tyre.
- Lutu që pastorët e kishës suaj të përjetojnë përparim frymëror në besimin e tyre, që, kështu, e gjithë kisha të përjetojë përparim frymëror nën udhëheqjen e tyre.
- Lutu me zell që Zoti i të korrave të dërgojë më shumë punëtorë në të korrat e Tij (Mateu 9:38). Kërkoji Perëndisë të ngrejë një brez barinjsh besnikë, që kujdesen për delet e Tij, që sjellin dele të reja në vathë, dhe që e ripërtërijnë dinjitetin e ofiqit të pastorit në shoqëri.